



## KONTRATE SHITJE KUOTASH TE KAPITALIT THEMELTAR

Ne Durrës, sot më 04.02.2014 (dymije katermbedhjete), ditën e Martë, në zyren e noterise, përpara meje noterës Rovena Jakova, anetare e dhomes së notereve Durrës, me seli në Lagja nr.4, rruga "Egnatia", u paraqiten personalisht shtetasit e pershkruar me poshte:

**PALA SHITESË: SERDAR CAN HAKLIOL**, i biri i Hasan-it, lindur në Mersin, me dt. 10.02.1984, banues në Tiranë, Rr.Nikolla Tupe, nenshtetas turk, mbajtes i Pashaportes personale të Republikës Turke me Nr. U06750789, leshuar me date 25.04.2013 dhe date skadimi 24.04.2023.

**PALA BLERËSE: GJOVANA SOKOLAJ**, e bija e Kole, e datelindjes 04.03.1983, lindur në Iballe, Puke dhe banuese në Lushnjë, Lagja "Kadri Qystri", e identifikuar nga Leternjoftimi ID me nr.029906845, nr.personal I35304130I, leshuar me date 28.09.2010 dhe date skadimi 27.09.2020.

*Madhore e me zotesi të plote juridike e për të vepruar, të cilët me dëshirë dhe me vullnetin e tyre të lire dhe të plote me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash, në baze të ligjit nr.9901 date 14/04/2008 "Për shoqëritë tregtare", në të cilën deklaruan:*

Në baze të Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar, rezulton se me date 22.06.2006 është themeluar shoqëria me përgjegjesi të kufizuar "SOKOLAJ" SHPK, me NIPT K64312403D, me seli në Fier, Lushnjë Lagja "Kadri Qystri", me ortakë themelues:

**Zj. GJOVANA SOKOLAJ**, e cila zoteron 50% të kuotave të kapitalit themeltar të kesaj shoqërie me vlerë 50 000 (pesedhjetë mijë) leke.

**Z. SERDAR CAN HAKLIOL**, i cili zoteron 50% të kuotave të kapitalit themeltar të kesaj shoqërie me vlerë 50 000 (pesedhjetë mijë) leke.

Shtetasi **SERDAR CAN HAKLIOL** kuotat e tij takuese, që zoteron në shoqërinë "SOKOLAJ" shpk, në masën prej 50% të kuotave të kapitalit themeltar me vlerë 50 000 (pesedhjetë mijë) leke ia shet palet blerëse **Zj.GJOVANA SOKOLAJ** të ciles i kalojnë 50 kuota pra 50% të kapitalit themeltar në vlerën prej 50 000 (pesedhjetë mijë) leke përveç 50 kuotave (50%) të cilat ajo i zoteron tashmë në këtë shoqëri.

Pala blerëse **GJOVANA SOKOLAJ** deklaroi se është dakort me blerjen e këtyre kuotave me vlerën e dhënë prej 50 000 (pesedhjetë mijë) leke, duke ja paguar palet shitesë këtë shumë jashtë zyres noteriale.

Shitesit garanton blerësin për kalimin e pronësive së kuotave të tij takuese në kapitalin themeltar të shoqërisë "SOKOLAJ" SHPK në gjendje të lire, nga cdo lloj detyrimi ndaj të tretëve.-----

Me nënshkrimin e kesaj kontrate, ortakët **SERDAR CAN HAKLIOL** heq dorë nga zotërimi i pjesës prej 50% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**ZJ.GJOVANA SOKOLAJ** mbetet ortak e vetme e Shoqerise "SOKOLAJ", shpk duke zoteruar gjithë kapitalin e kesaj shoqerie ne masen 100%.

Kontrata pasi iu lexohet te lartperemendureve prej meje noteres me ze te larte dhe te qarte,dhe ata deklarojne se jane dakort me permbajtjen e saj, pasi ky eshte vullneti i tyre i lire dhe i plote,nenshkruhet prej tyre personalisht ne prezencen time.

Une noterja Rovena Jakova vertetoj rregullisht kete akt noterial ne baze te ligjit nr.7829 date 01/06/1994 "Per noterine".



**PALËT**

**PALA SHITSESE  
SERDAR CAN HAKLIOL**

**PALA BLERESE  
GJOVANA SOKOLAJ**

*Serdar Can Hakliol*

*Gjovana Sokolaj*

*[Handwritten signature]*

**NOTERE  
ROVENA JAKOVA**


*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*









**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit te Kerkimit:	D-20140204104435489
Data e Rezultatit te Kerkimit:	04.02.2014
Ora e Rezultatit te Kerkimit:	10:44:35AM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-163-11255
Referenca e Perdoruesit:	



**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

SOKOLAJ SH.P.K.



*Valleone JP*